

Azilkërkuesit në Shqipëri

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente.....	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Popullsisë dhe Cens, Drejtoria e Popullsisë dhe Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Indrit Mustafa
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Përgjegjës në Sektorin e Statistikave të Popullsisë dhe Cens
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë.
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	imustafa@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / 240
1.8. Numri i faksit	+355 (4) 228 300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	04.07.2025
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	04.07.2025
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	04.07.2025
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Statistikat për azilkërkuesit u referohen shtetasve të huaj, që aplikojnë për format e mbrojtjes ndërkombëtare, që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve dhe personave në mbrojtje plotësuese në Shqipëri. Qëllimi i publikimit vjetor për azilkërkuesit në Shqipëri është paraqitja e rezultateve dhe treguesve për azilkërkuesit në Shqipëri sipas muajit të aplikimit, vendeve të origjinës, si dhe numrin e individëve që kanë marrë apo kanë lënë shtetësinë Shqiptare. Të dhënat mbi azilkërkuesit dhe fitimit ose lënies së shtetësisë në Shqipëri sigurohen nga Departamenti i Kufirit dhe Migracionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtoria e Politikave të Shtetësisë dhe Drejtoria e Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut në Ministrinë e Brendshme, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet.

	Të dhënat mbi azilkërkuesit përmbajnë informacion statistikor mbi: • Azilkërkuesit sipas vendit të origjinës • Kërkesat për azil • Kërkesat për azil sipas muajve • Vendimet për azilkërkuesit • Marrja e shtetësisë Shqiptare sipas grup-moshës dhe vendit të origjinës • Lënia e shtetësisë Shqiptare sipas grup-moshës
3.2. Sistemi i klasifikimit	Klasifikimi i shtetësisë bazohet në listën e kodeve ISO-3166 (duke përdorur alfa-2), të përshtatur sipas nevojave të vendit . Këto ndryshime konsistojnë në ndryshime të vogla që kanë ndodhur me kalimin e kohës për të pasqyruar krijimin e vendeve të reja ose shtetësive. Në disa raste, këto kategori të shtetësisë nuk janë të njohura botërisht, por përdoren dhe njihen nga Shqipëria.
3.3. Mbulimi i sektorit	Informacioni statistikor mbulon të dhënat për Azilkërkuesit, vendimet, marrja dhe lënia e shtetësisë në Republikën e Shqipërisë
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	Azil është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve dhe personave në mbrojtje plotësuese. Azilkërkues është çdo shtetas i huaj ose person pa shtetësi, që ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, për të cilën nuk është marrë ende një vendim përfundimtar i formës së prerë. Aplikim për azil është kërkesa zyrtare e një personi të huaj apo pa shtetësi, para autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, e cila vlerësohet si një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, sipas Konventës së Gjenevës së OKB-së, “Mbi statusin e refugjatit”. Çdo kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare vlerësohet si aplikim për azil, përveç rastit kur i huaji kërkon qartazi një lloj tjetër mbrojtjeje, për të cilën aplikohet veçmas. Kërkesë për azil është çdo deklaratë e një personi të huaj apo pa shtetësi, e shprehur në çfarëdo lloji mënyre e në çfarëdo kohe përpara autoriteteve kompetente, në pikat e kalimit kufitar apo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili kërkon mbrojtje ndërkombëtare, sipas konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar. Shtetësia shqiptare fitohet, rifitohet, humbet apo lihet në përputhje me dispozitat ligjore për shtetësinë shqiptare, të cilat respektojnë normat e parimet e njohura të së drejtës ndërkombëtare në fushën e shtetësisë, të pranuar nga Republika e Shqipërisë. Shtetësia shqiptare fitohet me: a) lindje; b) natyralizim; c) birësim Marrja e shtetësisë fitohet nga një i huaj që ka paraqitur kërkesë për marrjen e shtetësisë shqiptare, në rast se plotëson kushtet e paracaktuara në ligj. Lënia e shtetësisë shqiptare nënkupton se pasja e shtetësisë shqiptare merr

	fund sipas kërkesës së personit, kur ai plotëson kushtet e paracaktuara në ligj. Shtetas i huaj është personi i cili nuk është shtetas i Republikës së Shqipërisë dhe ka shtetësi të huaj Person pa shtetësi është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti. “Refugjat” është shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrethanave, në përputhje me kriteret e nenit 1 (A) të Konventës së Gjenevës. Shtet apo vend i origjinës është shteti, shtetësinë e të cilit mban kërkuesi ose në rastin e personave pa shtetësi, vendbanimi i zakonshëm i mëparshëm. Status i mbrojtjes plotësuese është njohja në Republikën e Shqipërisë e të huajit ose personit pa shtetësi, si person i pranueshëm për mbrojtje plotësuese. Status i refugjatit është njohja në Republikën e Shqipërisë e shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi si refugjat.
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është individ.
3.6. Popullata statistikore	Statistikat e azilkërkuesve u referohen individëve të vendeve të tjera që kanë aplikuar për azil në Shqipëri, personat që kanë marrë dhe kanë lënë shtetësinë Shqiptare.
3.7. Zona e referencës	Territori i Republikës së Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Që nga viti 2017 dhe në vijim INSTAT ka kryer publikime të përvitshme me të dhëna të agreguara në nivel vendi. Të dhënat janë të disponueshme nga viti 2015 dhe në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Invididët.
5. Periudha e referencës	Ky raport i referohet vitit 2024.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Baza ligjore për prodhimin e treguesve të Azilkërkuesëve në Shqipëri, është pjesë e bazës ligjore të INSTAT: • Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026

	Konceptet statistikore dhe përkufizime bazohen në: • Ligji Nr. 10/2021 “Për Azilin Në Republikën E Shqipërisë” • Ligji Nr.113/2020 “Për Shtetësinë”
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Aktualisht nuk ka shkëmbim të dhënash në nivel Evropian.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat konsiderohen konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrotja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikën zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk u shpërndan palëve të treta të dhënat e mbledhura nga, apo tek të cilat ka akses, të dhëna këto që mund të shërbejnë në identifikimin drejtpërsëdrejti apo tërthorazi të njësive statistikore që i kanë ofruar të dhënat në fjalë për arsye dhe qëllime statistikore, apo të dhëna të vjela nga burime të tjera administrative. INSTAT ndërmerr tërë masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga Instituti i statistikave vetëm në rast se: a) këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; b) njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave. Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i Institutit të Statistikave. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajeve që mund të shpërdahet dhe të bëhet publike nga Instituti i Statistikave, me qëllim që të bëhet i pamundur identifikimi i njësisë statistikore nga këto të dhëna; kriteret e anonimizimit për të dhënat mikro që u ofrohen përdoruesve; dhënia e aksesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e

publikimeve	publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesit i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikatat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi; 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshhtësia e shpërndarjes	Statistikat për Azilkërkuesit në Shqipëri publikohen një herë në vit.
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Sipas kalendarit të publikimeve, të dhënat për Azilkërkuesit në Shqipëri shpërndahen çdo vit me një publikim më vete, në data specifike. Publikimi mundësohet në faqen zyrtare të INSTAT, gjithashtu shpërndahen elektronikisht tek përdoruesit. Njoftimet dhe vonesat publikohen në kalendarin e publikimeve. Në rastin e vonesave, specifikohet data tjetër e botimit dhe shpjegimi i arsyeve të vonesave.
10.2. Publikime	Përdoruesit mund t'i gjejnë publikimet në faqen e internetit të INSTAT të organizuara nën temën: • Azilkërkuesit në Shqipëri
10.3. Baza e të dhënave on-line	Publikimet me të dhënat mbi Azilkërkuesit për periudhën 2017 - 2024 mund të konsultohen lehtësisht në seksionin e dedikuar të faqes web. Gjithashtu në këtë seksion disponohet seria e të dhënave mbi fitimin dhe lënien e shtetësisë Shqiptare.
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Aksesit në të dhënat mikro nuk aplikohet.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Të dhënat janë siguruar nga burime administrative. Një shpjegim i shkurtër rreth përkufizimeve dhe metodologjisë për statistikatat e azilkërkuesit gjendet në

	publikimin përkatës si dhe në raportet e cilësisë.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Popullsisë dhe Cens dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat për Statistikat e Azilkërkuesit në Shqipëri, për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Kontrollet e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryen përgjatë gjithë procesit. Stafi i përfshirë në faza të ndryshme të përpilimit të të dhënave është i mirë trajnuar dhe me përvojën e duhur. Burimi i të dhënave për Statistikat e Azilkërkuesit në Shqipëri është administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Publikimi i të dhënave për azilkërkuesit kanë një përdorim të gjerë kryesisht për planifikimin e politikave bazuar në evidenca, sepse shifrat e azilkërkuesve përdoren për të analizuar një sërë treguesish social dhe ekonomik, nga përdorues të ndryshëm ndër të cilët më kryesorët janë: • Qeverisja qendrore; • Qeverisja lokale; • Bota Akademike; • Përdorues të zakonshëm. Informacioni mbi nevojat e përdoruesve për të dhëna mbi azilkërkuesit, dhe perceptimet e tyre në lidhje me to matet në disa mënyra: • Klikimet (Page Views) e produktit përkatës në website-n e INSTAT; • Takime me përdorues të ndryshëm duke lejuar ata të diskutojnë mbi kërkesat dhe nevojat e tyre; • Kontakte me përdorues të cilët kontaktojnë individualisht sektorin e Statistikave të Popullsisë dhe Cens mbi kërkesat e tyre specifike, apo dërgojnë në INSTAT këkesat e tyre lidhur me statistikën për azilkërkuesit.

12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave të Migracionit dhe Integrimi i Migrantëve është vlerësuar me 3.74 (74,4%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).						
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave për statistikën e “Azilkërkuesit në Shqipëri” për vitin 2024 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të parashikuara në Programin e Statistikave zyrtare (2022-2026). Shkalla e plotshmërisë së të dhënave, për Azilkërkuesit në Shqipëri për vitin 2024, është 100%.						
13. Saktësia dhe besueshmëria							
13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton burimet përkatëse të të dhënave për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave nëse shihet i nevojshëm ose të konfirmohen në mënyrë zyrtare.						
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.						
13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.						
14. Afatet kohore dhe përpikmëria							
14.1. Afatet kohore	Rezultatet e statistikave për Azilkërkuesit në Shqipëri janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 185 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 185 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Azilkërkuesit në Shqipëri është 31 Dhjetor 2024. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2024</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>7/4/2025</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>185</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2024	Data e publikimit	7/4/2025	Afatet kohore	185
Periudha referuese	12/31/2024						
Data e publikimit	7/4/2025						
Afatet kohore	185						
14.2. Përpikmëria	Të dhënat e Statistikave për Azilkërkuesit në Shqipëri publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Statistikave të “Azilkërkuesit në Shqipëri” ka qenë i përpiktë në kohë në tërësinë e publikimeve të kryera gjatë viteve. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2024</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2024				
Periudha referuese	12/31/2024						

	Data e shpallur	7/4/2025	
	Data e publikimit	7/4/2025	
	Vonesa në kohë	0	
15. Koherenca dhe Krahaseshmëria			
15.1. Krahaseshmëria gjeografike	Statistikat për Azilkërkuesit në Shqipëri paraqiten në nivel vendi. Këto statistika janë të krahaseshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënat koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënave.		
15.2. Krahaseshmëria kohore	Statistikat për Azilkërkuesit në Shqipëri datojnë që nga viti 2015 , duke siguruar një krahaseshmëri të gjatë kohore prej 10 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=10). Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahaseshmërinë e tyre në seri kohore.		
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.		
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu vlerësimi i serive kohore dhe trendi i tyre.		
16. Kostoja dhe ngarkesa	Sektori i Statistikave të Popullsisë dhe Cens është pjesë e Drejtorisë së Popullsisë dhe Statistikave Sociale. Stafi i përfshirë në procedurat e mbledhjes së të dhënave, kontrollit të të dhënave, përditësimit dhe mirëmbajtjes së statistikave punon me kohë të plotë dhe është si më poshtë: 1. Përgjegjës 1 punonjës 2. Specialistë 3 punonjës Sa i përket të dhënave nga burimet administrative, ato janë pa kosto. Marrëveshjet e Bashkëpunimit ndërmjet INSTAT dhe Departamentit të Kufirit dhe Migracionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Politikave të Shtetësisë, si dhe dhe Drejtorisë së Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut në Ministrinë e Brendshme krijojnë mundësinë e transmetimit të të dhënave pa kosto.		
17. Rishikimi i të dhënave			
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit për Statistikat e Azilkërkuesit në Shqipëri bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë: - Politika e Revizionimit; - Politika e Trajtimit të Gabimeve.		
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast se burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi Statistikat e Azilkërkuesit në Shqipëri do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e ardhshëm shoqëruar me një shënim shpjegues për përdoruesit.		

	Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi Azilkërkuesit për vitin 2024, subjekt i këtij raporti.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Për statistikave të azilkërkuesve burimi i të dhënave janë vetëm të dhëna administrative.
18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen njëherë në vit.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat mbi Azilkërkuesit në Shqipëri janë të dhëna me burim administrativ. Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e indikatorëve dhe statistikave mbi Azilkërkuesit në Shqipëri për vitin 2024, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji Për Statistikat Zyrtare. Departamenti i Kufirit dhe Migracionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtoria e Politikave të Shtetësisë, si dhe Drejtoria e Politikave të Migracionit, Azilit dhe Antitrafikut në Ministrinë e Brendshme janë burimi kryesor i të dhënave për të gjitha treguesit që publikohen sipas këtij programi.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Kontrolle logjike dhe matematike kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, ashtu sikundër kryhen për të gjithë treguesit, që INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	